

# Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër  
Viti III i botimit, Maj 2009 Nr. 25. Çmimi 20 lekë.  
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

## FORMOHET PARTIA DEMOKRATIKE E BASHKIMIT TE MUSLIMANEVE SHQIPTARE

**N**ë mediat e shkruara dhe vizive sapo është dhënë informacioni se spektrit politik në Shqipëri i është shtur edhe një parti e re e cila është Partia demokratike e Bashkimit të muslimanëve shqiptarë. Dalja e kësaj partie do të jetë edhe një shans më shumë për atë pjesë të elektoratit shqiptar i cili nuk e ka pranuar politikën që i kanë afuar partitë politike egzistuese, gjithashtu do të jetë edhe një shans më shumë për muslimanët shqiptarë të cilët tashmë kanë edhe një parti të tyre e cila do të jetë edhe më shumë e angazhuar në mbrojtje të interesave të tyre krahas mbrojtjes ligjore që kanë si të gjithë bashkëkombasit e tjerë. Si pozicion politik kjo parti i përket qendrës së djathë e gatshme gjithmonë që të jetë edhe pjesë e aleancave që mund të organizojnë forcat e djathta, gjithmonë marrëveshje të arritura në harkkohor pas zgjedhor. Duke komentuar iniciatet e kësaj partie qytetari shqiptar e ka të qartë se ka të bëjë me një parti demokratike e cila nuk mund të penalizohet si ekstremiste-fetare dhe si pjesë e strategjisë së saj ka bashkimin e muslimanëve shqiptarë si pjesë e forcimit të unitetit të vetë qytetarëve shqiptarë. Politika e mbrendshme e Partisë Demokratike të Bashkimit të Muslimanëve Shqiptarë do të jetë një politikë transparente e cila do të stimulojë prodhimin dhe rritjen e ekonomisë në të gjithë treguesit e saj duke stimuluar biznesin vendas dhe atë të huaj, gjithmonë duke ruajtur edhe interesat kombëtare të vendit. Duke e pas ë të qartërisht se paraqet korrupsionin për shoqërinë e sotme shqiptare, kjo parti do të jetë një kundërshtar epakalueshëm për korrupsionin në të gjitha sferat e shoqërisë së sotme shqiptare, ku prioritet do të ketë lufta kundër korrupsionit në administratë dhe në shëndetësi të cilat janë bërë plagë të rënda për shoqërinë shqiptare duke kërcënuar edhe imazhin e Shqipë-



risë para faktorit ndërkombëtar. Si pjesë e strategjisë së saj, ajo zotohet që të angazhohet për kthimin e pronës tek pronari i vërtetë i saj duke i dhënë fund makinacioneve që bën sot politika shqiptare sa majtas dhe djathtas për të dëmtuar interesat e pronarëve të vërtetë. Duke e njohur saktë realitetin e religjoneve fetare në Shqipëri, Partia Demokratike e Bashkimit të muslimanëve shqiptarë do të bëjë përpjekje të gjithanëshme që në Shqipëri tolerance fetare të jetë një dukuri reale dhe kjo tolerance nuk duhet zbatuar duke penalizuar interesat e religjionit musliman por, duke krijuar kushte dhe mundësi për një bashkëjetesë të vërtetë fetare, larg propagandës dhe trukeve politike që e kërcënojnë këtë bashkëjetesë. Në programin e saj që është shumë transparent dhe demokratik, kjo parti u siguron anëtarëve të saj të drejtat dhe detyrat që kanë ku e drejta e fjalës dhe liria shprehjes janë prioritet i këtyre të drejtave. Lufta kundër krimet të organizuar është pjesë e ren-

dësishme e strategjisë së kësaj partie sepse kjo dukuri sot është një kërcënim i rrezikshëm për arritjet edemokracisë në Shqipëri dhe njëkohësisht opionencë shumë e rrezikshme një politikë transparente dhe rezultative për ecjen e Shqipërisë në njëlinjë me vendet që kanë parametra të lartë zhvillimi. Në politikën e jashtme Partia Demokratike e Bashkimit të Muslimanëve Shqiptarë ka në strategjinë e saj marrëdhënie korrekte me shtetet fqinjë ku vend të rendësishëm do të zënë marrëdhënjet ekonomike me interes reciprok, pa harruar edhe nisim të tjera që do të ndërmerren në interes të të dy palëve. Por rendësi të veçantë do të kenë marrëdhënjet me vendet evropjane, SHBA Turqinë, vendet e Lindjes së Mesme dhe ato aziatike duke treguar se politika e jashtme e partisë është gjithpërfshirëse, por duke ruajtur interesat kombëtare të vendit. Njëkohësisht kjo parti përshëndet anëtarësimin me të drejta të plota të Shqipërisë në NATO sinjë arritje që forcon

sigurinë dhe pozitën e SHqipërisë në arenën ndërkombëtare. Formimi i Partisë Demokratike Shqiptare do të jetë një mundësi më shumë për të mbrojtur e identitetin e muslimanëve në Shqipëri nga pozicionet e qëllimshme apo të paqëllimshme që e çenojnë këtë identitet duke bërë atë pa të drejtë objekt të mediave të shkruara dhe vizive duke sjellë kështu një presion psikologjik mbi muslimanët shqiptarë të cilët mund ta shohin vehtën në pozitën "e armikut të klasës" e thënë ndryshe pengesë për t'u integruar në Evropë. Zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të jenë një test për mbështetjen që dote këtë në elektoratit shqiptar kjo parti sepse publikisht është e njohur pjesëmarrja e Partisë Demokratike të Muslimanëve Shqiptarë në zgjedhjet parlamentare në qersho 2007, ku ajo do të konkurojë e vetme jashtë çdo kualicio.



# Muhammedi a.s. është shembulli më i lartë për njerëzimin

**M**uhamedi a.s. është i dërguari i Allahut dhe peygameri i fundit që i është dërguar njerëzimit nga Allahu xh.sh. Muhamedi a.s. është i biri i Abdullahut dhe ka lindur në Meke në vitin 570 të erës së re. Në rininë e tij ishte kombinimi i vetive më të mira shoqërore dhe shembullor me një gjykim të pagabueshëm. Ai shquhej për inteligjencën e mendimit dhe zgjedhjen e saktë të mjeteve për arritjen e qëllimeve konkrete. Mendja e tij e kthjelloi dhe natyra e tij e pastër ishin vlera për të kuptuar jo vetëm mënyrën e jetës, por edhe për të njohur individë, komunitete dhe grupe të caktuara njerëzish. Ai ishte i dashur, i sjellshëm, i panjollësor në asnjë tregues të karakterit të tij. Me paraqitjen e tij, me temperamentin e butë dhe me një fetyrë të ndritur, ai linte mbresë të pashlyeshme tek ata që e njihnin. Respekti ndaj të dërguarit të Allahut ka qenë dhe është e paarritshme nga askush tjetër. Ata që e njihnin ishin gati të sakrifikoreshin edhe për një lëndim të vogël të tij. Ai ishte njeri me tipare të persosura dhe shokët nuk mund ta krahasonin me asnjë tjetër dhe e donin aq shumë. Kur ishte 40 vjeç, Allahu i shpalli ajetet e parë përmes melekut Xhibrildhe e ngarkoi me detyrën e Pejgamerit. Allahu xh.sh. i ngarkoi mesazhin e njeshmërisë së Allahut dhe të paralajmëronte njerëzit për rrezikun e politeizmit. Politeistët e Mekës kundërshtuan Muhamedin a.s. dhe pasuesit e tij. Por, kjo dhunë nuk i pengoi njerëzit të shkojnë pas tij dhe as nuk arritën ta pengojnë në përhapjen e mesazhit islam. Kur pjesa më e madhe e popullit të Medinës përqafoi Islamin, muslimanët e Mekës u shpërngulën në Medinë për të themeluar shtetin islam. Disa vite më vonë, politeistët e Mekës u mposhtën nga muslimanët dhe Meka u çlirua. Islami u përhap edhe pas vdekjes



së Pejgamerit a.s. duke mposhtur dy perandoritë e mëdha të kohës, atë Perse dhe Romake. Shumë personalitete të njohura të botës e kanë pranuar karakterin e përkryer të Profetit a.s. Benard Shouka shkruar: "Unë besoj se nëse një njeri si ai do të merrte pushtetin në botën moderne, Ai do të kishite qenë i sukseshëm në të gjitha problemet, duke sjellë paqë dhe lumturi." Kurse Lamartini do të pohojë se madhështia e qëllimit, mjetet e pakta dhe rezultatet mahnitëse, janë tre kriteret e gjenit njerëzor. Kush mund të krahasojë ndonjë njeri të madh të historisë me Muhamedin? Ndërsa udhëheqësi i Indisë, Gandi do të deklarojë se nuk ishte shpata që siguroi fitoren e Islamit .... por mbështetja tek Zoti dhe misioni i tij që shkatërruan çdo pengesë para tij.

Hyrja e Profetit në Mekë si fitues ishte madhështore, sepse doli dikur nga Meka i rrethuar nga armiq dhe u kthye i rrethuar tashmë nga miq, shokë, muhaxhirë, ensare mbi kokat e të cilëve ishim melaikët. Kurse Xhibrili

a.s. endej në mes të tij dhe Allahut duke i zbritur shpalljen. Njerëz nga të gjitha anët erdhën për të hyrë në dritën në të cilën Ai i ftonte. Por kjo nuk e bëri mendjemadh, sepse Profeti a.s. ishte kundërshtar i madh i saj. Ai hyri në Mekë si fitues, por nuk mori hak ndaj atyre që e keqtrajtuan duke u thenë të shkonin se ishin të lire dhe nuk kishte qortim për ata. Kur Profeti a.s. arriti fitoren dhe suksesin, atij iu shpall ajeti: "Ne ty të dhamë fitore të sigurtë dhe Allahu të liroi prej gjynaheve të mëparshme dhe atyre të mëvonshme dhe të plotësua mirësinë ndaj teje dhe të orjentuam ty në rrugë të drejtë. Allahu të ndihmon ty me një ndihmë të fortë. (EL Feth\1,) Gjithashtu, kur Muhamedi a.s. e kreu misionin dhe dërgoi në vend amanetin, Atij i zbriti fjala e Allahut: "Sot e përsosam fenë për ju, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe për ju Islamin e zgjedha për fe." Por sihariqi i Allahut e obligoi Profetin a.s. të shtojë adhurimet dhe veprat e mira duke thenë se duhet të jem rob dhe falenderues ndaj Zotit tim (transmeton Buhariu dhe

Muslimi). Muslimani e ka detyrë që ta shtojë dashurinë ndaj të dërguarit të Allahut xh.sh dhe ta dojë atë më shumë se çdo krijesë, sepse ai mbetet shembull për të gjithë njerëzimin deri në shkatërrimin e saj. "Ju tek i Dërguari i Allahut keni shembullin e mrekullueshëm" (El-Ahzab\21

Jeta dhe vepra e Profetit a.s. duhet të ketë rendësi për besimtarin si zemra e tij, pa të cilën ai nuk mund të jetojë. Përmes shembullit të tij, Allahu na meson të jetojmë me besim dhe të mos rrëshqasim në errësirë. Të mos harrojmë se Ai është i vetmi për të cilin kemi informata të sakta të cilat nuk i kemi as për të afërmit tone më të dashur.

Paqë dhe mëshira e Allahut qoftë për të Dërguarin e tij, Muhamedin a.s., Vulën e të gjithë peygamerëve, për familjen e tij dhe për ata që ndjekin rrugën e tij.

**Kujtim Cufaj**

**Imam xhamia Kullaj**



# Familja madhështore e Bushatllinjëve të Shkodrës

**B**ushatllinjët janë ndër fiset më të mëdha në Shkodër. Kjo familje feudale me origjinë shqiptare, njihet mjaft në Shkodër që në shekullin e XV, për traditën e saj të sundimit e ndikimit në qytet e krahinë. Nga kjo familje e madhe shkodrane, që mbas periudhës së vezirëve e deri në dekada të vona dolën udhëheqës e prinjës të popullit, qoftë në raste revoltash, qoftë ndër beteja për mbrojtjen e atdheut. Hysen e Jusuf Begu, janë të dy eksponentë të kryengritjes popullore të quajtur kryengritja e Hamz Kazazit në vitin 1834, nipi i tyre, Selimi i Tahir Begut mori pjesë aktive në luftën e Miletit dhe në Lidhjen e Prizrenit. Reshit Begu, mori pjesë si prijës i çetave shkodrane në lufrat kundër Malit të Zi në vitin 1876 dhe u dekorua për trimërinë e tij. Beqir Begu i priu shkodranëve në luftën e Shpuzës, krahas Dasho Shkrelit. Këtyre burrave populli shqiptar u ka kënduar këngë trimërie. Shaban Begu, djali i Ali Begut u shqua si luftëtar i Lidhjes së Prizrenit, sikurse e tregon dhe kënga e kalasë së Tivarit, pasi ai ishte prijësi i luftëtarëve shkodranë që luftuan për mbrojtjen e kësaj këstjelle. Shaqir Begu, djali i Shabanit, kryesoi çetën shkodrane në luftën e Miletit, dhe luftoi trimërisht në Rrzhanicë krahas me Dedë Gjo Lulin, kundër malazezëve. Xhemal Shaqir Bushati dhe Visho Bushati, dhanë kontributin e tyre si patriotë që para shpelljes së pavarësisë, dhe më vonë u zgjodhën nga populli deputetë e anëtarë asambleje bashkiake. Në skenën e politikës shqiptare shfaqen Sylço Begu (Bushati), në luftën e Koplikut dhe Maliq Bushati, deputet, ministër e kryeministër në vitet 1941-1943. Këtij fisi i takojnë dhe klerikët e njohur muslimane Haxhi Haliti, Molla Rrustemi dhe Haxhi Sabri Bushati. Dy oficerë të njohur të xhandarmarisë shqiptare në vitet 1920-1924 kanë qenë Malo Begu, nënkolonel, emigrant politik 1925-1939 dhe Hasan Begu. Pas çlirimit, pjestarë të shquar të kësaj familjeje pësuan persekutime nga më të rëndat. Pati shumë të pushkatuar, të burgosur, të internuar dhe arratisur. Janë pushkatuar Sylço Bushati (Begu), Maliq Bushati dhe Qazim Bushati. Janë dë-

nuar 15 veta, si Myfti Myrto Bushati, Sheuki Bushati, Met Bushati, Maliq Xhemal Bushati, Refik Bushati, Haki Bushati, Ahmet Emin Bushati, Myfit Qamil Bushati, etj., Janë internuar Hamdi e Fadil Bushati. Ndërsa janë arratisur 6 veta: Xhelal, Enver, Mustafa, Irfan, Njazi Busha Prejardhja e Bushatllinjve lidhet ngushtë me emrin Bushat, një fshtat shumë i hershëm i Shkodrës që ndeshet në dokumenta që në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Origjina e kësaj familjeje të vjetër feudale shqiptare është në fshatin Bushat të Shkodrës dhe ajo kishte autoritet dhe privilegje që në shekullin e XV të periudhës para pushtimit osman. Pema gjeonealogjike e Bushatllinjve është mjaft e dendur dhe ka 5 degë kryesore, në dukje të pavarura nga njëra tjetra, ku një pjesë e saj është botuar për herë të parë në vitin 1927 në numrin 12 të revistës Dituria, nga njëri prej pinjollëve të kësaj familjeje, Hamdi Bushati. Kjo pema e përgjithshme, që qarkulloste në disa familje bushatllinjsh. Pavarësisht pretendimeve të disa studiuesve sllavë për ta nxjerrë këtë familje me origjinë sllave, asnjëherë kjo nuk është vërtetuar dhe është fakt i njohur që të gjithë studiuesit e mirëfilltë turq dhe shqiptarë e kanë vërtetuar se kjo familje ishte shqiptare, me saraje në Bushat e që më vonë për vetë rolin e vendin që zuri në histori, u vendos në kryeqendrën e veriut, në Shkodër. Në historinë tonë kombëtare, tema e Bushatllinjve të Shkodrës zë një vend me rëndësi për faktin se ato drejtuan për 75 vjet Pashallekun e Shkodrës që u dallua për tendencën për autonomi dhe shkëputje nga Turqia si dhe zhvillimin ekonomik e kulturor pozitiv që pati. Sundimi i tyre i përket fazës së dytë të administrimit të Shkodrës nga Turqia, në vitet 1757-1831, që historiografia e quan periudha e sundimit të Pashallekut të Shkodrës. Për Bushatllinjët ka të dhëna të shumta gojore, të dhëna bibliografike dhe dokumentacion autentik si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në turqisht. Themeluesi i dinastisë së Bushatllinjve është Mehmet Pashë Plaku, me të cilin fillon një periudhë stabiliteti: me faljen e gjaqeve, bashkimin e Shkodrës me Malësinë e Madhe e

Mirditën, zgjerimin e kufijve deri në Pejë dhe në Jug, deri në Elbasan. Në këtë periudhë bie në sy politika e tij drejt shkëputjes nga Turqia. Zhvillimi ekonomik, toleranca fetare, mirëkuptimi e lidhjet për bashkim i jepnin forcë këtij pashalleku, aq më tepër kur në politikën e jashtme ruhej një farë ekuilibri, kurdoherë në interes të vendit. Me Mehmet Pashë Plakun nis periudha më e shkëlqyer e dinastisë së Bushatllinjve që zgjati rreth 100 vjet deri me kapitullimin e Mustafa Pashës, vezir i fundit i tyre. Fillimisht ndoqi një politikë elastike ndaj Turqisë dhe pas fuqizimit të tij, filloi të mos respektonte detyrimet ndaj Portës së Lartë, e cila në vitin 1775 e helmoi tinëzishit. Sipas historianëve ai pati merita se ishte i pari që hapi shtigjet e një modeli të ri vetersundimi, ngriti flamurin e mosbindjes ndaj urdhëresave sulltanore me qëllim shkëputjen. Duke patur guximin të deklarohej si autonom në qeverisjen e vendit. Mehmet Pashë Bushatliu ndihmoi në bashkimin e qytetarëve të përçarë të Shkodrës nga konfliktet e feudalëve paraardhës si dhe në harmoninë bashkëfetare, duke siguruar bashkëpunimin e tyre në planin politik, administrativ e shoqëror. Në vitin 1773, ndërtoi Xhaminë e Plumbit sipas stilit të xhamive të Stambollit, objekt ky që aktualisht është monument kulture, një ndër më të bukurit që ka Shkodra, por funksionon dhe si vend lutjesh. Pasardhësi i tij Mustafa Pasha, ishte djali i madh i Mehmetit dhe luante rol të rëndësishëm në administrimin brendshëm të pashallekut. Porta e Lartë nuk e njohu asnjëherë atë si sundimtar të Shkodrës dhe e përdori ndër shërbime luftarake deri sa në vitin 1779, ra viktimë e një helmimi nga ana e Sulltanit, që ushqente urrejtje ndaj Bushatllinjve. Pas tij, pashalleku i Shkodrës drejtohet nga ajo që historianët e kanë quajtur figurën kryesore e Bushatllinjëve, Kara Mahmut Pasha. Trimëritë e Kara Mahmut Pashë Bushatliut janë trashëguar në legjenda, këngë e rrëfime të popullit në breza. Por, pozitive në periudhën e sundimit të tij mbeten dëshira e puna për bashkim, toleranca fetare. Politika e jashtme aktive që ndoqi për të cilat ekzistojnë dokumenta e botime sllave, turke,

italiane, Ai punoi për krijimin e një konfederate ilirike, kryetar i së cilës u zgjodh. Kara Mahmut Pashë Bushatliu u emërua nga Porta e Lartë si vezir i Shkodrës. Efektivisht ai e ka sunduar Shkodrën nga viti 1775, por sipat të dhënave të historianit turik A. Xhevdet, ai u njoh zyrtarisht si sundimtar i Shkodrës në vitet 1779-1780. Zgjerimi ndikimit të tij bëri që Turqia t'i hiqte emërimin e vezirit dhe të dërgonte disa herë ushtri ndëshkuese ndaj tij. Synimi ambicioz i tij ishte të bëhej sundimtar i gjithë Shqipërisë. Me këtë synim ai organizoi një kuvend në Podgoricë, në mars 1786 me qëllim bashkimin e forcave që do të luftonin kundër Turqisë dhe krijimin e Konfederatës Ilirike. Vritet më 22 shtator në afërsi të fshtit Kruz, në luftë me malazezët. Vdekja e tij i gëzoi mjaft malazezët, të cilët shihnin tek Kara Mahmut Bushatliu një pengesë të pakapërcyeshme për pushtimin e tokave shqiptare. Sukseset që ai arriti në fuqizimin e Pashallekut të Shkodrës gjatë 21 viteve që e udhëhoqi lidhen me aftësitë e talentin e tij dhe me mbështetjen që siguroi nga shtesa të ndryshme të shoqërisë si: feudalë, tregtarë, zejtarë, malësorë. Ai diti të shfrytëzonte momente kritike në qeverinë osmane për të forcuar pozitën e tij brenda Pashallekut. Ndoqi një politikë të urtë sociale, ekonomike, juridike e arsimore. Pas vdekjes së Kara Mahmutit, pashallekun e drejtoi vëllai i tij, Ibrahim Pashë Bushatliu. Historiografët osmanë e paraqesin Ibrahim Pashën si një sundimtar të bindur ndaj Turqisë që nuk veprroi si paraardhësi i tij. Vdiq në vitin 1809. Mehmet Pashë Bushatliu ishte një tjetër pinjoll i kësaj familje. Ai gezonte perakrahe ne malesi, por u vra me në pabesi Mustafa Pashë Bushatliu drejtoi në vitet 1810 - 1831. Ai vdiq në Medinë në vitin 1860. Pashalleku i Shkodrës ishte një formacion politik qe bashkoi një pjesë të madhe të Shqipërisë veriore dhe krijua 20 vjet para atij të Janinës dhe jetoi 10 vjet më shumë se ai. Gjatë 75 vjetëve të ekzistencës së vet, (1757- 1831) ai u qeveris pa ndërprerje prej 5 përfaqësuesve të familjes se fuqishme feudale të Bushatllinjve të Shkodrës.

# KONCERT MADHESHTOR I MEDRESESE HAXHI SHEH SHAMIA

**D**iten e enjte, me 30 prill 2009, ne teatrin "Migjeni," nxenesit e medrezese "Haxhi Sheh Shamia" dhane nje koncert madheshtor fetar ne kuader te perkujtimit te Ditelindjes se Profetit, Muhamedit .a.s. Ishte nje paraqitje dinjitoze e ketyre nxenesve para besimtareve muslimane dhe publikut te gjere, e cila ka nje rritje cilesore nga premiera ne priemiere, duke treguar se drejtoria e ketij institucioni mesimor- fetar e ndjen vehten me te angazhuar se kurre, kur duhen organizuar aktivite per figuren e ndritur te Muhamedit a.s. Mendojme se te pranishmit, ne sallin e teatrit Migjeni, u bene deshmitare te nje organizimi te persosur te ketij aktiviteti qe kishte filluar me ftesat qe ishin nje hyrje e bukur per ate qe do te shikonin te pranishmit ne ata dy ore aktiviteti i cili filloi me nje lexim shume emocional dhe me nivelin e larte te Kuranit te Madherueshem, duke vazhduar me recitimin e shkelqyer te vajzave te medrezese te cilat lartesian para publikut tiparet hyjnore te Profetit a.s. Vlerat e ketij koncerti duket se ishin vene ne rralle njera pas tjetres per te konkuruar, sepse secili moment i ketij koncerti mori "piket maksimale". Ajo qe te bente pershtypje, ne koncertin e organizuar sivjet, ishte fryma fetare e tij e cila pasqyrohej ne nje nivel shume te larte. Sidomos, bene shume pershtypje dhe percollen emocione te pa-

harrueshme recitimi per dashurine ndaj Pejgamerit a.s. dhe nje kenge shume mbreselenese turke qe u kendua nga Alban Kali. i shoqeruar nga kori i djemve dhe ai i vajzave. Publiku do ta kete te veshtire te harroje vivelin e larte te korit te djemve dhe te vajzave te cilet shkelqyen edhe permes nje veshjeje e cila e rriti ne zenit dekorin e ketij koncerti. Megjithese koncerti ishte i shtrire ne nje hark kohor thujse prej dy oresh, publiku e ndjeu vehten te habitur, kur e mori vesh se koncerti kishte mbaruar, duke treguar keshtu se ky koncert i kishte plotesuar parametrat e nje aktiviteti cilesor, sepse ishte percjelle "me nje fryme" nga publiku qe ishte i pranishem ne salle. Duhet vene ne dukje se besimtarete muslimane jane te interesuar qe te percjellin aktivite te tilla fetare, sepse ne keta aktivite ,ai shikon te manifestuara nje tematike dhe nje paraqitje mbrenda normave fetare islame, larg degjenerimit dhe imoralitetit me te cilin sot jane mbushur mediat e shkruara, vizive dhe aktivitetet e tjera me te cilat ai ballafaqohet vazhdimisht. Ne kete aspekt, angazhimi i dejtorese se medrezese, sidomos i drejtorit te saj, Kujtim Dervishi duhet pergezuar, sepe bejne perpjekje te lavdrueshme per t'u dhene besimtareve muslimane emocione fetare permes aktiviteve te medrezese, te cilat, per hir te se vertetes, priten me shume interes, gje qe duket tek pjesemarrja masive e publikut. Por, inter-

esimi per aktivite fetare ka terhequr edhe interesimin e organeve shtetore qendrore dhe lokale te cilet jane pjese e ketij publiku dhe jane po keto pushtetare qe pershendesin koncertet e medrezese duke i vleresuar per organizimin dhe cilesine e permbajtjes se tyre. Mendojme se keto aktivite fetare islame eshte mire qe te shtohen ne numur, duke zene sa me shume hapesine dhe kohe, ne menyre qe te behet edukata e dites per te rinjte muslimane ne Shkoder te cilet duhet te jane sa me larg degjenerimit dhe Shen Valentinit, 1 Majit dhe festave te tjera qe percjellin mesazhe imorale dhe degjeneruese permes aktiviteve qe behen me rastin e tyre. Menduam ta leme ne fund (ne asnje menyre per ta nenvleftesuar por per ta vleresuar) falenderimin per shoqaten turke te Stambollit qe financon medrezete e djemve dhe te vajzave dhe ne veçanti, z. Shuajp Bashan, per perkushtimin e tyre maksimal ne mbarevajtjen e ketyre institucioneve mesimor- edukative - fetare dhe angazhimin e tyre te panderprere per te prezantuar para publikut musliman ne Shkoder dhe me gjere mesazhin islam permes aktiviteve fetare, siç ishte kesaj rralle perkujtimi i Ditelindjes se Profetit te nderuar, Muhamedit a.s.

Selim Gokaj

## NE MEDRESENE HAXHI SHEH SHAMIA PERKUJTOHET 710 VJETORI I THEMELIMIT TE PERANDORISE OSMANE

**N**ë kuadër të 710 vjetorit të themelimit të Perëndorisë Osmane, në medrezën "Haxhi Sheh Shamia", u organizua një takim me pedagogun dhe historianin e Universitetit të Shkodrës, Luigi Gurakuqi, Pr.Dr. Bajram Xhafa, ku merrnin pjesë nxënës të kësaj medrezeje, dega e djemve dhe stafi pedagogjik i degës së djemve dhe i degës së vajzave. Takimi u organizua në mjediset e bibliotekës së medrezesë, një ambjent ky shumë komod dhe i pranueshëm për të realizuar takime me një tematikë të tillë. Në temën që trajtoi, Pr.Dr. Bajram Xhafa, në kuadrin e 710 vjetorit të themelimit të Perëndorisë Osmane, ai foli për raportet e kësaj Perëndorie me popullin shqiptar me të cilin e lidhi fatin të bashkëjetojë për disa shekuj me rralle. Në bisedë u theksua se shqiptarët dhe turqit nuk paten një raport të mirëfilltë pushtues dhe të pushuar, por raporti real ishte një bashkëjetese e mirëfilltë e cila u reflektua tek pjesëmarrja e shqiptarëve ne sferat më të larta të qeverisjes së Perëndorisë Osmane. Per këtë dëshmon edhe numuri

i konsiderueshëm i shqiptarëve në parlamentin e Perëndorisë Osmane, në mesin e të cilëve ishte edhe figura e njohur e Ismail Qemalit dhe e 40 kryeministrave të kësaj Perëndorie të cilët ishin shqiptarë. Medrezistët u njohën edhe me informacione për betejën e Fushë Kosovës, ku ushtria osmane fitoi mbi një koalicion të domonuar nga serbët, betejë në të cilën ra shehid Sulltan Murati, i cili, përmes një lutejeje që kishte bërë një natë para betejës, kishte kërkuar nga Allahu xh.sh. që t'ia plotësonte këtë kërkesë që islami kurrë të mos shuhej në hapësirën kosovare. Gjithashtu, medrezistët u njohën edhe me informacione mbi Camërinë e cila ka mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë, me gjithë përpjekjet e Perëndorisë Osmane për të penguar një gjë e tillë. Ajo që kishte rendësi në këtë bisedë ishte idea se ardhja e Perëndorisë Osmane në Shqipëri ishte një mundësi përcaktuese që shqiptarët të shpëtonin nga asimilimi ortodoks dhe humbja e identitetit të tyre si shqiptarë. Medrezistët i përcillnin me shumë kujdes fjalët dhe mendimet e Pr. Dr. Bajram Xhafës, sepse ishin informacione që ata i ndëgjonin

për here të pare. Pas përfundimit të kësaj bisede, medrezistëve iu dha mundësia që të bënin pyetje në lidhje me temën e trajtuar, duke marrë njëkohësisht përgjigje kompetente nga Pr.Dr. Bajram Xhafa. Biseda, që u zhvillua në Medrezë "Haxhi Sheh Shamia", është një përpjekje sa modeste, aq edhe serioze për t'u përcjellë medrezistëve një mesazh të saktë, të sinqertë, për të vërtetën e mardhënjeve të Perëndorisë Osmane me shqiptarët, si antiteze e një dizinformimi të qëllimshëm që vazhdojnë të bëjnë mediat për të vërtetën e këtyre mardhënjeve e cila, sipas historianëve dhe politikanëve të Turqisë gjendet vetëm në arkivat e shtetit turk. Në fund, drejtoria e medrezesë "Haxhi Sheh Shamia", falenderoi Pr.Dr. Bajram Xhafën për bisedën e mbajtur, duke i premtuar gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin në mes të medrezesë dhe z. Bajram Xhafa edhe në të ardhmen.

Samir Hoxhiq



# PRESIDENTI OBAMA VIZITON TURQINE

**M**ediat turke dhe ato nderkombetare bejne te ditur se presidenti amerikan Obama ka vizituar Turqine, ne perpjekje per te ulur tensionet ne mes te dy vendeve te cilat jane bere

te ceneshme ne vitet, kur ne Shtepine e Bardhe ligjin e benin republikanet me presidentin e tyre, Bush, i cili la pas nje shije te hidhur, sidomos me politiken e tij te jashtme qe spikaste qarte me nje dhune politike dhe ushtarake qe u ushtrua ne bote ,sidomos ndaj muslimaneve ne shume hapësira ku ata jetojne. Duke shfrytezuar ngjarjet e 11 shtatorit edhe ato te penalizuara per shkallen e vertetise, administrata Bush u be sfide e rende per shume qeveri si ne Lindje ashtu edhe ne Perendim te cilat e kundërshtuan ma sa paten mundesi politiken e republikaneve amerikane qe ndezen zjarre te rrezikshme ne Irak dhe Afganistan qe u sulmuan me akuza qe nuk u vertetuan kurre.Kjo politike e eger e Bushit e cila vertiti kaxhikun e

hekurt mbi kokat e muslimaneve, beri qe Turqia te ishte nder vendet me antiamerikane ne bote, gje qe u pa sidomos, kur parlamenti turk refuzoi kerkesen amerikane per te lejuar trupat amerikane qe te shfrytezojne territorin turk per te sulmuar Irakun.Jane te njohura edhe demonstratat qe u bene ne Turqi kunder Izraelit per krimet qe ai beri mbi palestinezet ne Gaza, ku u penalizuan edhe SHBA per mbeshtetjen qe u dha izraeliteve ne kete konflik.Presidenti amerikan Obama deklaroi ne Turqi se SHBA nuk ka qene ne konflik me boten muslimane dhe nuk do te jete kurre ne konflik me boten muslimane, duke dhene nje sinjal pozitiv ne mardhenjet e ardhshme ne mes te dy vendeve.Nga ana tjetër ishte Obama qe deklaroi se do te mbeshteste perpjekjet e Turqise per t'u anetaresuar ne Bashkimin Evropian.Duhet pranuar se vizita e presidentit amerikan Obama ne Turqi ishte nje levizje politike e studjuar mire qe do të krijojë një klimë të re ne mardhenjet e botës islame me SHBA, sepse ishte Ob-

ama ai qe deklaroi se Turqia i ka mundesite qe te luaj nje rol te madh ne permiresimin e ketyre mardhenjeve shume te ftohta qe sot egzistojne ne mes te muslimaneve, ne shkalle botërore, dhe te qeverisë se SHBA.Në këtë mënyrë po afirmohet idea se Turqia tashmë është bërë sot qendra politike e muslimaneve, qëndrimi i së cilës duhet marrë parasysh dhe njëkohësisht ajo duhet pyetur për probleme qe kanë të bëjnë me fatin e vendeve muslimane sot në botë,sepse Turqia sot mund dhe duhet të pranohet edhe si një Kalifat figurative per botën muslimane, me tendencë për t'u bërë nesor Kalifati i vërtetë për muslimanët të cilët kanë aq shumë nevojë për Kalifatin Islam.

Selim Gokaj



# FRANCA DEKLAROHET KUNDER PRANIMIT TE TURQISE NE BE

**A**xhensite e njohura boterore te lajme bejne te njohur nje deklarate të ministrit të jashtëm të Francës Lymier i cili gjatë një konference shtypi foli edhe për zgjerimin e BE.

Lymier theksoi se BE duhet ta ndërpresë zgjerimin e saj pas pranimit të vendeve të Ballkanit deri në një moment tjetër, kur të jenë studjuar mundesi të reja për ta vazhduar këtë process. I pyetur nga gazetarët për pranimin e Turqisë në Be, Lymier tha se nuk jemi të përgaditur për një panim të Turqisë në Bashkimin Evropian .Kjo deklarate ishte në kundërshtim me Presidentin amerikan Obama i cili tha se hyrja e Turqisë në BE është e drejtë dhe se SHBA do ta mbështeste Turqinë në përpjekjet e saj për t'u bërë pjese e BE. Duket se qeveria franceze është përfaqësue-

se e vërtetë e demonstratave që janë bërë vazhdimisht kundër pranisë në BE të Turqisë. Megjithëse nuk jepen haptas arsyet, ata tashmë jenë të njohura.Disa nga vendet e BE e refuzojnë Turqinë, sepse ajo ka një popullsi me shumicë absolute muslimane e cila trajtohet si një dukuri e frikshme për Perëndimin.Qëndrime të tilla publike nuk kanë bazë historike ,por fetare,gjë që i jep botës Perëndimore një pamje të qartë antiislame duke zbardhur edhe qëndrimet e tyre politike ushtarake në rajonet e nxehta të globit, ku u ndezën zjarre dhe po ndezen zjarre kundër muslimanëve. Kujtojmë qëndrimet e trupave franceze dhe te ushtarakëve te lartë francezë në lufrat e përgjakshme në Bosnje dhe Kosove ku ata u dalluan për qëndrim të hapur kundër popullsisë muslimane dhe luftëtarëve muslimanë në këto hapësira.Me këtë qëndrim, Franca , Austria dhe disa vende evropiane

po krijojnë idenë se bota islame po përjeton mentalitetin e kryqzatave ne kohë moderne dhe se perparimi kolosal ekonomik nuk i ka mjaftuar Evropës se krishtere qe të reformohet në drejtim të tolerances fetare, pavarësisht thirrjes së vazhdueshme që bën Papa nga sheshi i Shen Pjetrit dhe gjatë vizitave të tij në vende të ndryshme për tolerance fetare, megjithese në raste të veçanta edhe ai e ka nxitur këtë intolerance fetare në disa momente të prononcimit të tij mediatik. Duket se në Perëndim janë shqetësuar nga qëndrimet e fundit të Turqisë në mbrojtje të muslimanëve të cilat u bënë publike, kur kryeministri Erdogan akuzoi Izraelin si shtet vrasës për masakrat në Gaza dhe kundërshtoi kandidaturën e kryeministrit danaz Rasmundsen për postin e sekretarit të NATOS,sepse kishte perkrahur karikaturat kundër Profetit, Muhamedit.a.s.Por, Turqia duket se "nuk është e da-

shuruar aq shumë" pas BE,sepse ajo tashmë është ndër shtetet më të fuqishme ekonomikisht dhe ushtarakish ne botë dhe hyrja e saj në BE do ishte edhe nje vlerë më shumë për Bashkimin Evropian. Eshtë një fakt i njohur refuzimi që i bënë pranimit në BE turqit permes një anketimit mediatik, duke i përçjell një mesazh Evropës se ajo nuk duhet të përdorë standarte të dyfishta për t'u zgjeruar dhe se penalizimi Turqisë nga ana e saj tregon se politikat e vjetra po zbatohen ne kohe të reja, ne nje kohe qe popujt kane dëshire te integrohen dhe te jetojne ne paqe e miqesi larg paragjykimëve dhe urrejtjes fetare.

Kjo vlere arrihet vetem kur politika te shikoje perpara dhe te heqe dore nga mentalitetet dhe fantazmat e se kaluares.

Selim Gokaj

# QENTE ANTIMUSLIMANE LEHIN KARVANI I MUSLIMANEVE ECEN PERPARA

(për ata që bejnë presion mbi bashkëpunëtorët e gazetës "Besimtari")

**G**azeta "Besimtari", si pjesë e mediave muslimane në Shqipëri, ka si pikësynim që të kontribojë për problemet më të cilat ballafaqohen muslimanët në Shqipëri dhe më gjërë, gjithmonë në mënyrë modeste, por edhe gjithmonë mrenda parametrave ku është fokusuar feja islame dhe muslimanët. Por, e rendësishme është se gazeta "Besimtari" ka si strategji të saj mbrojtjen politike të muslimanëve dhe të fesë islame, sepse edhe penalizimi që u bëhet sot muslimanëve bëhet nga ky këndvështrim dhe nuk është parë në media ndonjë shkrim ku flitet për numurin e vakteve që duhet të falë një besimtar musliman, apo ku duhet të vendosë duart, kur falet një besimtar musliman. Konsolidimi i një linjë të tillë "të forte" ka bërë që gazeta të jetë shumë e kërkuar nga lexuesi aq sa, tirazhi që botohet është i pamjaftueshëm. Theksojmë se "Besimtari" në asnjë shkrim të tij nuk ka penalizuar institucionet islame, as në rang myftinësh, as në rang më të lartë, megjithëse kami pasë shkrime të shumta në drej-

tim të tyre që nuk i kemi botuar, sepse nuk është ky misioni i kësaj gazete, pa harruar se problemet në këto institucione janë reale dhe evidente. Kemi arsyetuar se probleme të tilla nuk duhen bërë publike, por duhen trajtuar gjithmonë në një tryezë bisedimesh, sepse na mjafton oponenta e ashpër që na bëhet nga segmente që e kanë në strategjinë e tyre penalizimin e muslimanëve dhe të fesë islame në Shqipëri dhe më gjërë. Është e qartë se pista mbi të cilën operon gazeta "Besimtari" nuk është e pëlqyeshme dhe e pranueshme nga segmente dhe persona të caktuar të cilët e shohin vehten të zbuluar përballë mesazhit që përcillet në faqet e "Besimtarit". Prandaj, nuk kanë munguar përpjekjet për ta penalizuar atë si gazete radikale dhe ekstremiste, si gazete me gabime ortografike, epitete të vëna në emer të moderatorëve muslimanë të cilët faktikisht janë diversionistë në rrallët e muslimanëve. Këto "reformatorë" dhe "moderatorë", për të cilët islami dhe problemet e tij janë pjesa më e parëndësishme e jetës së tyre, pasi "lehin" pa pushim kundër "Besimtarit" dhe botuesve të tij, kanë filluar të bëjnë presion edhe mbi bashkëpunëtorët e "Besimtarit" që ata mos të dergojnë shkrime tek ai. Këto

veprime të mjerueshme, por njëkohësisht edhe antiislame, nuk janë shqetësim për mbarëvajtjen e "Besimtarit", por janë shqetësim për shkallën e rrezikshmërisë që paraqesin segmente dhe persona të tillë nga rrallët e muslimanëve të cilët, në emër të një tolerance të rreme dhe të një moderatori diversionist, bëhen pjesa më e rrezikshme e cila vepron kundër interesa të muslimanëve dhe të fesë islame. Problemi që po trajtojnë nuk është një problem personal dhe pikërisht që mos të marrë një ngjyrë të tillë, ne nuk po i botojmë në faqet e "Besimtarit" emrat e këtyre "toleranteve dhe moderatorëve", por që në një përshkallëzim të diversionit të tyre kundër linjës islame të "Besimtarit", do ta shohin vehten të ekspozuar në faqet e "Besimtarit" përballë lexuesve të tij të cilët do të shokohen kur të shohin emrat e tyre, sepse faktikisht misioni i "Besimtarit" është që të demaskojë ata që janë pjesë e linjës që cënon muslimanët dhe fene islame, tregues që këta "lehtë" klubesh dhe tavolinash i plotësojnë saktësisht. Por portreti që po u bëjmë atyre që penalizojnë dhe bëjnë diversion kundër linjës së gazetës "Besimtari" është vetëm maja e azbergut e portretit të tyre të vërtetë, sepse nuk dihet

saktë se "në çfarë sporteli e marrin bukën "këto tolerantë dhe moderatorë moderne bashkohorë". Por për një gjë jemi krejt të sigurtë. "Sporteli" ku ata zgjasin duart kur nuk është "sporteli islam". Ne u rekomandojmë këtyre "moderatorëve"; dhe "tolerantëve" se janë të mirëpritur të botojnë alternativat e tyre në faqet e "Besimtarit", ose në takime direkte në një tavolinë bisedimesh me drejtuesit e "Shoqatës Bamirëse" dhe të botuesve të "Besimtarit" ku mund të shfaqin rezervat e tyre të cilat mund të jene të pranueshme dhe pozitive, sepse respektet hipokrite dhe shterngimet fallso të duarve, duke mbajtur pas shpine "thikën" për t'ia ngulur vëllaut musliman, janë mënyra të vepruari qafirash. Por nuk duhet harruar se "Thika" të tilla kanë dy teha dhe njëri nga këto "teha" mund të jetë rrisht i këtyre "toleranteve" dhe "moderatorëve" që në një dorë tundin degën e ullirit, kure në tjetrën i tundin islamit kërbaçin.

Haxhi Vehbi Dani

Kryetar i Shoqatës Bamirëse  
Shkoder

## MUSLIMANE ME DIJE ISLAME POR ME BESIM TE KUFIZUAR ISLAM

**N**ë Kuranin e Madhëruar, Allahu xh.sh. i ka urdhëruar besimtarët që të lexojnë dhe përmes këtij leximi ata të bëhen të ditur, sepse dituria është ajo që i lartëson muslimanët dhe u forcon besimin. Gjithmonë më të fituar për të marrë dije janë ata që shkollohen në shkolla të larta, dije kjo që vazhdon gjatë gjithë jetës, sepse njerëzimi ecën përpara dhe njerëzitet e ditur bëhen të paditur, kur nuk i shtojnë dijet me arritjet e reja sidomos ku ata janë të ditur. Por, më të fituarit e të fituarve janë ata që marrin dije fetare islame, sepse aty është e verteta dhe aty janë përgjigjet për gjithshka që një njeri i zakonshëm, ose besimtar kërkon

të dije. Por, vlera më e madhe që përfiton ai që studjon dhe përvehtëson dije fetare është rritja e besimit dhe e përkushtimit fetar, duke pasë për mision që këto dije t'i hapë në masën e besimtarëve dhe më gjërë. Por, takojmë fatkeqësisht raste, kur një njeri i shkollur në shkolla të larta fetare nuk jep shembullin e një besimtari që dijen të cilëne ka marrë në shkollë ta manifestojë në marrëdhënjet me besimtarët muslimanë. Një mik shumë i shqetësuar dhe i indinjuar, po më tregonte për një person të tillë me të cilin nuk kishte bërë asnjë debat fetar, apo afetar dhe në një shkëmbim ballëpërballë nuk i kishte dhënë selam, aq më tepër në ambjentet e xhamisë, ku besimtarët po përgaditeshin të falnin nama-

zin e xhumasë. E vetmja përsëritje që kishte marrë miku im nga njeriu i shkolluar kishte qenë një lëvizje e lehtë koke dhe pak përdredhje buzësh. Pa dashje m'u kujtua një thënie e një imami për njerëz të tillë të cilët, sipas tij, ata kishin mbaruar shkollën në mënyrë aksidentale dhe po në mënyrë aksidentale ishin bërë të ditur në fenë islame. Por, fatkeqësisht, me sjellje të tilla ata prezantojnë një shkallë të kufizuar besimi në islam, sepse deviza madhështore e islamit që besimtarët muslimanë janë vëllezër, për ata është e panjohur, sepse nuk e praktikojnë në raportet e tyre me besimtarët muslimanë. Miku që shprehu këtë shqetësim është një aktivist i njohur për mbrojtjen e fesë islame dhe shpër-

blimin e pret nga Allahu xh.sh. për aq sa bën për islamin. Por, shqetësimi që ai kishte, tregon se nuk ishte i preku në sedër nga qëndrimi i njeriut të shkolluar, por shqetësohej nga injoranca e këtyre njerëzve që mendojnë sa e kanë të drejtën t'u vendosin "notë" kaluese, ose jo kaluese besimtarëve në një kohë që vetë ato janë "mbetës" që duhet të ulen përsëri mbi libra, për të mesuar të vërtetën për besimin islam të cilin duhet ta përcjellin si mesazh në rrallët e besimtarëve muslimanë.

Alban Kastrati



## DAMIR FAZLLIQIT GJYKATA E APELIT I KTHEN PRONAT

**M**ediat e shkruara dhe ata vizi-ve bejnë të ditur se biznesmenit boshnjak, z. Damir Fazlliq, Gjykata e Apelit ka marrë vendim që t'ia kthejë pronat të cilat prokuroria shqiptare ia kishte bllokuar duke u bazuar në akuza të shpikura dhe të rreme, të cilat kishin qëllim që të krijonin një opinion denigrues kundër këtij biznesmeni i cili operon në biznesin shqiptar me atë të drejtë që operojnë bizneset greke, italiane dhe të vendeve të tjera perëndimore. Në një numur të kaluar të

gazetes "Besimtari," ne e rrëzuar me fakte dhe informacione reale portretin jo të vërtetë që krijuan mediat dhe politika e majtë shqiptare kundër biznesmenit boshnjak që ka ardhë në Shqipëri për të investuar dhe për të operuar financiarisht, duke dhënë një ndihmesë modeste për ekonominë shqiptare. Si shpërblim, politika e majtë i ndërseu mediat për të penalizuar padrejtësisht biznesin e z. Damir Fazlliq, duke angazhuar edhe drejtësinë shqiptare në këtë penalizim. Por, ngjarjet e biznesit të z. Damir Fazlliq nuk morën atë rrugë që kërkoi politika e majtë shqiptare

dhe mediat e saj. Gjykata e Apelit ka vendosur që t'ia kthejë pronat biznesmenit boshnjak të cilat ishin sekustruar pa të drejtë, duke treguar se ai është një biznesmen i ndershëm dhe punon me para të pastërta. Arsyeya përse u sulmua biznesmeni boshnjak në Shqipëri është dhënë pa doreza nga gazeta "Besimtari". Tashti, që z. Damir Fazlliq iu kthyen pronat nga drejtësia shqiptare, argumentet tona për biznesmenin boshnjak dëshmojnë se kanë qenë shumë të sakta. Mbetet që politika e majtë dhe mediat më të zellshme që e "ngritën zërin deri në qiell" kundër biznesmenit

boshnjak, të vendosen para drejtësisë për shpifje dhe në rastin më të favorshëm për ata, të kërkojnë falje publikisht para opinionit publik shqiptar të cilin e mashtruan me akuza të qëllimshme, për të mbajtur sa më larg biznesin boshnjak nga Shqipëria ashtu si i mbajtën larg nga Shqipëria refugjatët boshnjakë që po largoheshin nga shtëpitë e tyre nga genocidi serb i viteve 1992-1995.

Selim Gokaj

## NJE HARTE TURISTIKE QE CENON RAPORTET FETARE

**N**ë një shtet ku popullsia është e përbërë nga tre besime fetare, ka shumë rëndësi që në të gjithë treguesit e aktiviteteve politike, ekonomike dhe kulturore që bëhen të respektohen religjionet fetare përmes paraqitjes së raporteve fetare sa më pranë të së vërtetës. Ky është një obligim si për vetë drejtuesit e religjioneve fetare, ashtu edhe për vetë strukturat e shtetit, sepse paraqitja jo e saktë e këtyre raporteve krijon një shqetësim tek religjioni të cilit i mohohet vendi i vërtetë që ai zë në popullsinë e atij vendi. Këto probleme që trajtuam më lart janë shqetësim

edhe në Shqipëri, ku popullsia e dominojnë tre religjione fetare. Për fat të keq, shumë here struktura shtetërore dhe në veçanti mediat, përpiqen që të dizinformojnë opinionin publik dhe në veçanti të huajt, me raporte fetare fiktive që janë shumë larg realitetit të vërtetë. Sidomos, ka përpjekje të vazhdueshme dhe të gjithanshme për të zvogluar numurin e muslimanëve në Shqipëri. Idea për të trajtuar një temë të tillë na lindi, pasi një besimtar musliman ishte shqetësuar dhe indinjuar nga pamja e një harte turistike ku u bëhej e ditur turistëve të huaj dhe vendas për shtrirjen e veprave të kultit të tri feve kryesore që janë në Shqipëri.

Pa i numëruar inicialet që portretizojnë këto vepra kulturi të vendosura në këtë hartë, syri të kap një realitet të shtrembëruar të raporteve fetare në Shqipëri. Në sipërfaqen e hartës mbizotërojnë haptas dhe pa doreza kryqet e krishterë në një kohë që inicialet e fesë islame janë minorancë. Të mos harrojmë se kjo hartë u jepet turistëve në aeroportin e Rinasit, ku është vendosur një bust i stërmadh i Nënë Terezës në formë kryqi, që shumë mire mund të ishte berë më pamjen e një bamirëseje, sepse pikërisht si bamirëse ne këtë figure e vendosim nëpër sheshe dhe jo si fetare. Veprime të tilla çenojnë identitetin real të shqiptarëve, sepse i japin atij pa-

drejtësisht një pamje dominante të krishterë. Të mos harrojmë se veprime të ngjashme me këto që shtruan më sipër kanë sjellë reagi-me nga shoqatat dhe institucionet islame, duke krijuar një klimë që nuk u ka shërbyer as nuk do t'u shërbejë kurrë shqiptarëve. Prandaj, nuk duhen lejuar veprime të tilla që gjithmonë janë të qëllimshme, sepse ndjenjat fetare të një bashkësie gjithmonë duhen respektuar në emër të bashkëjetesës fetare.

Selim Gokaj

## ARABIA SAUDITE NJOHU PAVARESINE E KOSOVES

**P**residenti i Kosovës Fatmir Sejdiu deklaroi për mediat se qeveria e Arabisë Saudite ka deklaruar zyrtarisht se e ka njohur Pavarësinë e Kosovës, duke dhënë një sinjal premtues për njohjen e Pavarësisë së Kosovës dhe nga vendet e tjera të Konferencës Islamike, pjesëmarrëse e së cilës është edhe Arabia Saudite, e cila gjithashtu duhet theksuar se në këtë Konferencë ka një vend të veçantë. Presidenti Sejdiu tha

se njohja e Kosovës nga Arabia Saudite do të jetë një mundësi e madhe për bashkëpunimin e Kosovës me vendet muslimane. Duket se lidhshpë i politikës kosovare ka bërë kthesë në qëndrimin e saj ndaj vendeve muslimane dhe i ka thirrur mendjes të kujtojë se ndihma e vendeve muslimane gjatë konfliktit në Kosovë, ka qenë e jashtëzakonshme dhe sidomos ndihma humane ka qenë e pakonkurueshme, ku Arabia Saudite dhe Turqia ishin kontribuesit më të

mëdhej të kësaj ndihme. Të mos harrojmë se vendet muslimane, sidomos Turqia, kanë luajtur një rol me rëndësi në përsheptim e ndërhyrjes ushtarake dhe realizimin deri në fund të misionit të saj për largimin e forcave serbe nga Kosova, sidomos në momentin, kur një pjesë e politikës evropiane po kërkonte ndërprerjen e bombardimeve mbi Serbinë, gjë që do të sillte pasoja katastrofike për Kosovën dhe vetë rajonin. Reagimi i Serbisë, pas njohjes së Pavarësisë

së Kosovës nga Arabia Saudite, ishte i shpejtë. Ministri i jashtëm Vuk Jeremiç deklaroi se Serbia shpreh keqardhje nga kjo njohje e Kosovës nga Arabia Saudite, sidomos në këtë moment, kur problemi i Pavarësisë së Kosovës po trajtohet nga ana juridike nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës.

Vezhguesi politik

i "Besimtarit"



## Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.  
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit  
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme  
**MISH  
HALLALL**

E XHUMA  
PUSHIM → BESNIK ALUSHI  
ISMETI

**Produkt Hallall**

**KLIENTË TË NDERUAR!  
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,  
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:  
sallam, suxhuk etj.**

**2- Piceri hallall**

**3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni  
por hallalli i vërtetë është vetëm  
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"  
Cel: 0692101893